


30-06-2017

Nr. 0112-17 Regj. Nr. 07544

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË****URDHËR
PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE****Drejtuar:
Adresa:****Qendres Kombetare te Biznesit
Tirane****Për dijëni: Debitorit – Shoqëria “IBN” shpk me Nipt L21309010H
Adresa: Rr. Ismail Qemali, Ndërtesa 5, Hyrja 5, Tiranë****Për dijëni: Kreditorit – Shoqëria “ENO TD” shpk me Nipt K61809507M
Adresa: Autostrada Durrës – Tiranë, pranë Karburant “Kastrati”, Durrës**

Pranë “Shërbimit Përmbarimor ZIG Shpk” në referim të Vendim Nr. 2807 Akti, date 14.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, është vënë në ekzekutim ky *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore **0112-17Regj.** kërkesen e kreditorit Shoqëria “ENO TD” shpk me Nipt K61809507M, ndaj debitorit Shoqëria “IBN” shpk me Nipt L21309010H, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fature Tatimore Shitje Nr. 04, date 19.12.2014 me Nr. Serie 18724854”.

Pasi fillimisht u bë Lajmerimi Nr. 06661Prot, date 08.06.2017, për Ekzekutimin Vullnetar te detyrimit qe permban Urdheri i Ekzekutimit Vendim Nr. 2807 Akti, date 14.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane dhe nuk pati asnjë reagim nga ana e debitorit, u fillua ekzekutimi i detyrueshëm, referuar nenit 517 të K.Pr.Civile.

Me Shkresën Nr. 07395Prot, date 27.06.2017 “*Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative*”, është urdheruar vendosja e masës së sekuestros mbi aktivitet e debitorit Shoqëria “IBN” shpk me Nipt L21309010H.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Pala kreditore – Shoqëria “ENO TD” shpk me Nipt K61809507M, ka dërguar shkresën “Kërkesë për pushimin e ekzekutimit”, datë 30.06.2017, ku kërkohet pushimi i ekzekutimit të mëtejshëm të titullit ekzekutiv “Fature Tatimore Shitje Nr. 04, date 19.12.2014 me Nr. Serie 18724854”, për asye se pala debitore ka përmbushur tërësisht detyrimin ndaj Kreditorit – Shoqëria “ENO TD” shpk me Nipt K61809507M.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (b), nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

- Heqjen e masës së Sekuestros Konservative**, të vendosur me anë të shkresës Nr. 07395Prot, date 27.06.2017 mbi aktivitet e debitorit Shoqëria “IBN” shpk me Nipt L21309010H, me Adrese: **Rr. Ismail Qemali, Ndërtesa 5, Hyrja 5, Tiranë**.
- Të njoftohemi dhe informohemi menjëherë** në formë shkresore në lidhje me procedurën e heqjes së masës së sekuestros konservative nga ana Juaj.

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

- Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në dispozita ligjore, palët mund të paraqesin ankim te vecante para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhri.
- Ky urdhër mbahet në 4 (kater) kopje.

**“Shërbimi Përmbarimor ZIG Shpk”
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Alban KOTE**